



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME LUSHNJË SH.A

Specifikime teknike për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike i objekteve me punonjes shërbimi dhe sisteme alarmi të sinjalizimit e vëzhgimi dhe Shoqërim i Vlerave monetare”

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Të dhëna për shërbimin e kërkuar :

- ✓ Shërbim ruajtje në 5 (pese) vendroje me shërbim 24 ore pa ndërprerje dhe 2 vendroje me shërbim 8 ore Turni I (Arkat). Në vendrojet (5) me 24 ore shërbimi do të kryhet 4.98 roje për çdo vendroje ndërsa në 2 vendroje me 8 orarshë shërbimi do të kryhet me 1.2 roje secila.
- ✓ Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike me sisteme alarmi dhe kamera. Shërbimi me sisteme alarmi në vendroje me 24 ore shërbimi gjatë orarit 22.00 – 07.00, ndërsa në 2 vendrojet Arka do të kryhet gjatë orarit 16.00 – 08.00 nga e hëna në të enjte, ndërsa në ditët e shtuna nga ora 16.00 deri ditën e hënë ora 08.00, si dhe 24 ore në ditët e festave zyrtare (deri në orën 08.00 të ditës së parë të punës pas ditës së festës).
- ✓ Shërbim i shoqërimit dhe transportit të vlerave monetare me 1 (një) eskort e përbërë nga 3 punonjës shërbimi (njëri prej të cilëve shofer) dhe mjet të blinduar.

Kërkesat për zbatimin e shërbimit :

Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut, në bazë të Ligjit Nr.75/2014 dt.10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre

Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.

Rojet duhet të kenë leje arme.

Rojet e turnit të tretë të jenë të pajisur me armë

Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:

- a) Rregullorja e brendshme
- b) Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.
- c) Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.
- d) Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike.
- e) Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.
- f) Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.
- g) Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekte

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike, kërkohet për 7 (shtatë) objektet e mësipërm. Vendndodhja e rojeve do jetë brenda territorit/rrethimit të këtyre objekteve. Shërbimi do të kryhet në të gjitha objektet, sipas vendndodhjes dhe shpërndarjes teritoriale të objekteve.
2. Sh.P.S.Fizik të kryhet në zbatim të Ligjit 75/2014, Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.155 datë 29.05.2014, pika 3/a (për objektet e rëndësisë së veçantë, si depo uji...etj) si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre me armatim, uniformë, pajisje ndërlidhje dhe mjet transporti. Organizimi i shërbimit të bëhet me plan skicimi e dislokimi në vendosjen dhe shtrirjen e shërbimeve. Në çdo vendshërbim të ketë libër shërbimi për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me instruktazhin e nevojshëm nga Drejtuesi Teknik i Shoqërisë.
3. Punonjësit e shërbimit të jenë të certifikuar konform Ligjit 75/2014, gjatë ushtrimit të detyrës punonjësi të jetë i pajisur me uniformën, shenjën dalluese, emblemën, stemën e shoqërisë, dokumentin identifikues si dhe pajimet personale si shkop gome, hekura lidhës, rrip multifunksional, konform Udhëzimit të MB nr.130, datë 05.03.2015 “Për funksionimin e Shpsf”, si dhe të kenë kontrata pune me operatorin ekonomik.
4. Të sigurojë grup të gatshëm me punonjës shërbimi në mbështetje të njësive të shërbimit në terren për ndërhyrjen dhe parandalimin e rasteve të ngjarjeve. Grupi i shërbimit të jetë i pajisur me uniformë, armatim me autorizimin e përdorimit, ndërlidhje, automjet me logon e shoqërisë, si dhe pajisje të tjera speciale për ndërhyrje në raste emergjence.
5. Të vërë në dispozicion për sigurimin e objekteve, stacionet e pompave, depot e ujit, qendrën e kontrollit, të pajisur me sistem ndërlidhje, radiokomunikimi, radioalarmidhe të ofrojë shërbim/monitorimi 24 orë për menaxhimin e shërbimit.
6. Të mbulojë të gjitha shpenzimet si detyrimet fiskale, paga e rojeve, sigurimet shoqërore të personelit të punësuar nga ana e tij për ruajtjen e objekteve, shpenzimet për uniformat, armatime, ndërlidhje si dhe gjithë kompesimet e tjera të njohura me ligj.

7. Kontraktori mban përgjegjësi për dëmtimet apo vjedhjet që mund të ndodhin në objekte që ruhet nga ana e tij, kur këto vijnë si rezultat i moskryerjes me korrektësi të shërbimit apo mungesës së vigjilencës së rojeve, dhe që vërtetohet nga organet kompetente. Në këtë rast kontraktori detyrohet të bëjë ç'dëmtimin 100% të vlerës së dëmtuar.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Sistemet e Alarmit

1. Sistemi të realizohet në mënyrë të integruar për të gjitha shërbimet (sistem alarmi, GPS) në mënyrë që të bëjë sa më të lehtë dhe më fleksibël monitorimin nga operatorët e qendrës së kontrollit.
2. Sistemet e Alarmit janë Sisteme teknologjike elektronike moderne për sinjalizimin e hyrjes apo dëmtimeve të paligjshme në ambjentin e marrë në sigurim.
3. Përgjegjësit e objekteve garantojnë aktivizimin dhe ç'aktivizimin e alarmit në momentin e mbylljes dhe hapjes së objektit.
4. Shoqëria e sigurisë mban përgjegjësi pas aktivizimit të sistemit të alarmit në rast se vjedhja apo dëmtimi i materialeve në objektin e siguruar ka ardhur si pasojë e neglizhencës së shërbimeve të kësaj shoqërie.
5. Montimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të sistemit të alarmit janë përgjegjësi e shoqërisë private të sigurisë.
6. Sistemet e Alarmit të jenë me transmetim me GPRS, me sistem mbyllje me pult ose me tastierë me kod, me sensorë me kabëll ose me wireless.
7. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes, për pjesë ndërrimi, paisjet e zëvendësuara, zëvendësimin e baterive, sensorë të ndryshëm, DVR, Centrale të sistemeve të alarmit, kabëll rrjeti etj, gjatë procesit të shërbimit do të mbulohen nga vetë shoqëria e sigurimit për të gjithë kohën e parashikuar në kontratë.

Sistemet e Vezhgimit (Kamera per jashte)

Sensori I imazhit	2MP CMOS Sensor Imazhi
-------------------	------------------------

Sinjali I sistemit	PAL/NTSC
--------------------	----------

Piksela eficente	1920(H)*1080(V)
------------------	-----------------

Lentja:	2.8mm
---------	-------

Dalja HD e videos	1 Analog HD output
-------------------	--------------------

S/N Ratio: More than 62 dB

General

Konsumi i energjise Max. 4W

Kushtet e jashtme IP66

Pamja naten Deri ne 20 metra

Numri i vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme per çdo vendroje	Afati i levrimit
5	3 turne	4.98 punonjes	8 muaj Kontrata do te jepen nga moment i lidhjes se kontrates me OE e shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas percaktimit te AK me afat perfundimtar 8 muaj.
2	1 turn, ora 7.00-15.00	1.2 punonjes	
Shoqërimi i vlerave monetare	1 Turni I	3 punonjes sherbimi (ekskort)	8 muaj (nga e hena ne te shtune) Kontratat do te jepen nga moment i lidhjes se kontrates me OE e shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas percaktimit te AK me afat perfundimtar 8 muaj.

PER SHERBIMIN E RUAJTJES DHE SIGURISE FIZIKE TE OBJEKTEVE(NEN-KATEGORIA 1.3.A)

- ✓ **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** *“Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike i objekteve me punonjes sherbimi dhe sisteme alarmi të sinjalizimit e vëzhgimi”.*

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK.

- ✓ **Objektivat:**

-Të ruajë objektin në zbatim të Rregullores së Brendshme të Autoritetit Kontraktor.

- Të ruajë rendin dhe të sigurojë jetën e personelit.

✓ **Detyrat e kontraktorit:**

1. Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t'ja paraqesë Autoritetit Kontraktor.
2. Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t'ja paraqesë çdo muaj Autoritetit Kontraktor duke përcaktuar emrat e punonjësve të shërbimit për çdo ditë dhe për çdo turn.
3. Të ndërhyjë me grupin e gatshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi, në çdo rast që paraqitet nevoja dhe të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cënimit të institucionit ose të personelit.
4. Punonjësi i shërbimit ka për detyrë:
5. Të zbatojë Rregulloren e Shërbimit të hartuar nga Drejtuesi Teknik
6. Të zbatojë Rregulloren e Brendshme të institucionit
7. Të zbatojë grafikun për shërbimin me rojet private duke u paraqitur 10 minuta përpara dorëzimit të turnit.
8. Të sigurojë ruajtjen dhe rendin në këtë objekt.
9. Të mos lejojë futjen e personave në objekt pa flete-hyrje.
10. Të mos lejojë hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumentin përkatës.
11. Të sigurojë parkimin e automjeteve të A.K sipas vendeve të përcaktuara nga institucioni.
12. Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlikohjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë duke vënë në dijeni përgjegjës të tij dhe ky i fundit njofton personin e autorizuar të Autoritetit Kontraktor për çdo mangësi të konstatuar.
13. Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjës të rojeve dhe përgjegjës të shërbimeve të brendshme të institucionit, duke bërë shënime të përkatëse në librin e shërbimit.
14. Të njohë dhe zbatojë rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit. Në rast zjarri të marrë masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrëfikset, përgjegjës të rojeve dhe përgjegjës të shërbimeve të brendshme të institucionit.
15. Kur në objekt kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit dhe njofton menjëherë organet kompetente
16. Të jetë i paisur me armë dhe ta përdorë atë në bazë të legjislacionit në fuqi.
17. Të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me personat.
18. Ndalohet futja dhe qëndrimi i rojës në ambjentet e brendshme të objektit përjashtuar rastet për zbatimin e rregullores.
19. Rojes, gjatë kohës së shërbimit i ndalohet të pijë pije alkoolike, të flejë, të bisedojë me persona të jashtëm.

20. Të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cënimit të institucionit ose të personelit.

✓ **Ofruesi i Sherbimit duhet te plotësoje kërkesat e mëposhtme :**

1. Te jete i certifikuar nga autoritetet kompetente per ushtrimin e funksionit.
2. Te reflektoje nje sjellje korrekte dhe te respektueshme.
3. Gjate gjithë kohes se sherbimit punonjesi i Shoqerise SHPRSF duhet te respektoje rregullat e brendshme te Autoritetit Kontraktor.
4. Të kërkojë nga punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të Objektivit.
5. Punonjesi i Sherbimit duhet te jete i afte te reagoje dhe te veproje gjithmone ne perputhje me instruksionet e personave pergjegjes te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor.
6. Të gjithë punonjësit e shërbimit “Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, duhet te mbajne dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës ata detyrohen ta paraqesin atë sa herë u kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë apo organet e tjera ligjzbatuese.
7. Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen operacionale me elementet perberes dhe të gjitha materialet e nevojshme logjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” të publikuar ne Fletoren Zyrtare date 08.08.2014 dhe Udhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem “Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, publikuar ne Fletoren Zyrtare date 09.03.2018.
8. Ne zbatim te Nenit 27 pika c e Ligjit Nr.75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike “, punonjesi i sherbimit ka pergjegjesi te mbaje sipas rregullores armatimin personal dhe pajisjet e sherbimit, te perdore uniformen, shenjat dhe simbolet e SHPRSF-se vetem gjate kryerjes se detyres si dhe te perdore armen sipas legjislacionit ne fuqi.
9. Ne lidhje me perdorimin e forces, punonjesi e sherbimit duhet te zbatojne Nenin 33 te Ligjit Nr.75/14 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike“ ku percaktohet qarte se: *“Punonjësi i Shërbimit i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj. Punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri te shkopi i gomës. Punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj”.*
10. Drejtuesi Teknik i SHPSF-së është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe do te përgjigjet për organizimin, drejtimin, kontrollin e kryerjes së shërbimit për shoqërimin dhe sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit. Ai duhet te përcaktoje rregullat e funksionimit të SHPSF-së në lidhje me ruajtjen e objektit apo personit, si dhe te përpiloje

plandislokimin për çdo objekt së bashku me skemat e ruajtjes dhe plane të veçanta ruajtje për situata emergjente. Ai do të jetë përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe do të sigurojë bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje; Drejtuesi Teknik planifikon shërbimet për shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje.

- ✓ **Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Objektet e Sh.a Ujësjellës Kanalizime Lushnjë, Lagjja: “18 - Tetori” Lushnjë si edhe në ambientet e tjera të përcaktuara, të cilat Sh.a Ujësjellës Kanalizime Lushnjë i ka në pronësi/administrim, si mëposhte ;

Nr.	Objektet/Vendrojet	Sasia e vendrojeve	Numri i rojeve per çdo vendroje	Sherbimi që kërkohet	Instalim dhe verifikim i Sistemeve të Alarmi dhe Kamera vëzhgimi
1	Depo e Ujit Nr.1	1	4.98	Ruajtje fizike me punonjës shërbimi 24 orë e objektit dhe territorit	Sistem Alarmi + Kamera vëzhgimi
2	Depo e Ujit Nr.2	1	4.98	Ruajtje fizike me punonjës shërbimi 24 orë e objektit dhe territorit	Sistem Alarmi + Kamera vëzhgimi
3	Pika e furnizimit me ujë Konjat	1	4.98	Ruajtje fizike me punonjës shërbimi 24 orë e objektit dhe territorit	Sistem Alarmi + Kamera vëzhgimi
4	Zyrat e Drejtorisë Lushnjë	1	4.98	Ruajtje fizike me punonjës shërbimi 24 orë e objektit dhe territorit	Sistem Alarmi + Kamera vëzhgimi
5	Magazinë	1	4.98	Ruajtje fizike me punonjës shërbimi 24 orë e objektit dhe territorit	Sistem Alarmi + Kamera vëzhgimi
6	Arka Nr.1 Lushnje	1	1.2	Ruajtje fizike me punonjës shërbimi 8 orë e objektit dhe territorit nga e hëna në të shtunë	Sistem Alarmi + Kamera vëzhgimi
7	Arka Nr.2 Lushnje	1	1.2	Ruajtje fizike me punonjës shërbimi 8 orë e objektit dhe territorit nga e hëna në të shtunë	Sistem Alarmi + Kamera vëzhgimi

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS
PER SHERBIMIN E SHOQERIMIT TE VLERAVE MONETARE (NEN-KATEGORIA
1.3.B)**

✓ **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** “Shërbim i Shoqërim i Vlerave Monetare”.

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK.

✓ **Objektivat:**

Të sigurojë shoqërimin e personelit me vlerat monetare të arkëtimit ditor për kryerjen e derdhjes në bankë.

✓ **Detyrat:**

1. Grupi i shoqërimit të vlerave monetare të SHPRSF-se duhet të jete i perbere nga punonjes te certifikuar ne Nenkategorine 1.3.B sipas parashikimeve te Kreut VI pika C per shoqërimin e vlerave monetare. Keta punonjes duhet te jene te pajisur me mjete mbrojtese, uniforme dhe dokument identifikimi sic parashikohet ne Ligjin Nr.75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe Udhezimin Nr. 130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem botuar ne Fletoren Zyrtare date 09.03.2018 .
2. Ky Grup duhet te shoqeroje vlerat monetare qe i jane besuar dhe te siguroje jeten e personelit gjate transportit te vlerave monetare. Detyra e tij funksionale eshte Shoqerimi i sigurte i punonjesve (arketareve) te Autoriteti Kontraktor drejt filialeve te Bankave respektive sipas zgjedhjes se Autoritetit Kontraktor.
3. Punonjesi i Autoriteti Kontraktor (arketari/rja) duhet te shoqerohet nga roje te armatosura.
4. Per transportin e vlerave monetare Ofertuesi duhet te pajise punonjesit e sherbimit me arme sipas percaktimeve ligjore te Ligjit Nr.75 /2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike ”.
5. Shoqerimi duhet te kryhet nga nje mjet i Operatorit Ekonomik. Mjeti duhet te jete i blinduar, i loguar ne gjendje te rregullt teknike dhe dokumentare qe te kryeje shoqerimin e vlerave monetare. Automjetet që transportojnë vlera monetare ndalohet që të vendosin në to dhe te përdorin pajisje zanore alarmi apo sisteme pamore me dritë vezulluese.
6. Shoqerimi i vlerave monetare do te kryhet nje ose dy here ne dite sipas grafikut të ekzekutimit të përcaktuar dhe ne zbatim te plote te instruksioneve te personave pergjegjes te Autoriteti Kontraktor, me grafik sherbimi perkatesisht nga dita e hene - shtune.
7. Distanca qe duhet te mbulohet nga kompania e shoqërimit, nga Arka deri ne filialin me te afert te bankes
8. Koha maksimale e procesit te shoqërimit te vlerave monetare do te jetë 2(dy) ore.
9. Koha orare e shoqërimit të vlerave monetare do të jetë :sipas udhezimeve te A.K

✓ **Ofruesi i Sherbimit SHPRSF duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme :**

1. Te jete i certifikuar nga autoritetet kompetente per ushtrimin e funksionit.
2. Te reflektoje nje sjellje korrekte dhe te respektueshme.
3. Gjate gjithë kohes se sherbimit punonjesi i Shoqerise SHPRSF duhet te respektoje rregullat e brendshme te Autoritetit Kontraktor.
4. Punonjesi i Sherbimit duhet te jete i afte te reagoje dhe te veproje gjithmone ne perputhje me instruksionet e personave pergjegjes te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

5. Punonjesit e Shoqerise SHPRSF qe kryejne shoqerimin e vlerave monetare duhet te jene te pajisur me armatim sipas ligjeve ne fuqi dhe ne zbatim te Udhezimit te Ministrit te Brendshem Nr.130 datë 05.03.2018 “Per Funkcionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” si dhe me mjete speciale per perballimin e situatave nga sulme te mundshme me qellim grabitjen e vlerave monetare (Jelek antiplumb, Radio, Shkop gome, hekura lidhes etj).
6. Shoqëria private per te siguruar shoqerimin e vlerave monetare dhe për realizimin me korrektesi te detyrës duhet te vere në dispozicion të punonjësve armatim dhe pajisje të shërbimit; armatim personal sipas ligjit per armet, jelek antiplumb, hekura lidhes, shkop gome, radio nderlidhje dhe GPS.
7. Të gjithë punonjësit e shërbimit “Per Funkcionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, duhet te mbajne dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës ata detyrohen ta paraqesin atë sa herë u kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë apo organet e tjera ligjzbatuese.
8. Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen operacionale me elementet perberes dhe të gjitha materialet e nevojshme logjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” të publikuar ne Fletoren Zyrtare date 08.08.2014 dhe Udhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem “Per Funkcionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, publikuar ne Fletoren Zyrtare date 09.03.2018.
9. Ne zbatim te Nenit 27 pika c e Ligjit Nr.75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike “, punonjesi i sherbimit ka pergjegjesi te mbaje sipas rregullores armatimin personal dhe pajisjet e sherbimit, te perdore uniformen, shenjat dhe simbolet e SHPRSF-se vetem gjate kryerjes se detyres si dhe te perdore armen sipas legjislacionit ne fuqi.
10. Ne lidhje me perdorimin e forces, punonjesit e sherbimit duhet te zbatojne Nenin 33 te Ligjit Nr.75/14 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike“ ku percaktohet qarte se: *“Punonjësi i Shërbimit i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj. Punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri te shkopi i gomës. Punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj”*.
11. Drejtuesi Teknik i SHPSF-së është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe do te përgjigjet për organizimin, drejtimin, kontrollin e kryerjes së shërbimit për shoqerimin dhe sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit. Ai duhet te përcaktoje rregullat e funksionimit të SHPSF-së në lidhje shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje. Ai do te jete përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe do te siguroje bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje; Drejtuesi Teknik planifikon shërbimet për shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje.

- ✓ **Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Intenerari nga Arkat e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje deri tek Bankat ku do të kryhet depozitimi i vlerave motere të arkëtimit ditor.